

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE MALORE

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji për Zhvillimin e Zonave Malore

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Publikimi u bë në datë 01.10.2024, data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 29.10.2024.

Të interesuarit ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektligjin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: Eriola.Kocileri@meki.gov.al

3. Metoda e konsultimit

Projektligji u publikua, në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP) nga data 01.07.2024 deri me datë 29.07.2024, por nuk ka pasur asnjë koment.

Nisma mbi këtë projektligj u diskutua në hotel Rogner më datë 11.12.2024, me pjesëmarrje të grupeve të interesit si; Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Arben Pëllumbi, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Përfaqësues i Lartë i Ambasadës Britanike në Tiranë. Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Përfaqësues nga Paneli i Qytetarëve për turizmin rural dhe malor, Evelina Azizaj, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural. Përfaqësues të institucioneve qendrore si AAMV, AZHBR, AREB-eve etj, 61 bashkive të vendit, organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal, komuniteteve lokale, sipërmarrësve të turizmit, ekspertëve dhe qytetarëve, komunitetit të donatorëve, medias etj.

4. Palët e interesit të përfshira

Nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; 3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektligjin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: Eriola.Kocileri@meki.gov.al

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Nuk ka pasur asnjë koment.

**RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN PËR ZHVILLIMIN E
ZONAVE MALORE**

Çështja adresuar	e	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
		.			-